



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	05-833
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 21 -
Data: Datum: Date:	06.02.2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Datë	06.02.2017
Numri i referencës	MSH/DSHB/mgj/ /2017
PËR/ZA/TO:	Te gjithë Udhëheqësit e NjShB-ve Te gjithë Kryeinfermieret e NjShB-ve Te gjithë Drejtorëve te Burgjeve Z. Granit Shatri, Koordinator për Shëndet Mendor ne DShB
CC:	Dr. Imet RRAHMANI, Ministër i Shëndetësisë Z. Ardian MEHMETAJ, UD, Sekretar i Përgjithshëm i MSh Z. Sokol ZOGAJ, Drejtor i ShKK/MD
PËRMESPREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr. Sci. Udhëheqës i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Procedurat e Terapisë Mbajtëse me Metadon ne Burgje

Te nderuar,

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgoj Procedurat e Terapisë Mbajtëse me Metadon ne burgje!

Këto procedura duhet te aplikohen ne te gjitha Njësitë Shëndetësore te Burgjeve.

Për momentin janë te funksionalizuar dy qendra te Metadonit, ne NjShB ne Dubrave dhe Lipjan.

Faqe 1 nga 2

Brenda gjashtë (6) muajve do te funksionalizohen edhe dy qendra te tjera ne NjShB ne Smrekovnice dhe ne Gerdovc.

Përgjegjës për fillimin e punës ne këto dy qendra do te jete koordinatori i Shëndetit Mendor ne DShB dhe Udhëheqësit e dy NjShB ne Smrekovnice dhe Gerdovc.

Ju faleminderit për mirëkuptim

Me respekt!

Faqe 2 nga 2

Adresa: Ministria e Shëndetësisë, 10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon/Faks: + 377 (0) 44. 158 671; +381 (0) 38 200 24 161
<http://www.ks-gov.net/> Ministria e Shëndetësisë; E-mail: Milazim.Gjocaj@rks-gov.net





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Rregulloret dhe Format për Metadon në Burgje

Shkurt 2017, Prishtinë

Rregulloret dhe Format për Metadon në Burgje

1. Kriteret për Metadon
2. Rregullore për mënyrën e dhënies së Metadonit
3. Metadoni par ata që vijnë nga jashtë
4. Metadoni par ata që dalin jashtë
5. Rregulla dhe Deklarata për të burgosur
6. Protokoli i transportit të metadonit
7. F.1.1. Autorizim për transport
8. F.2.2. Pranim dorëzimi
9. F.3.3. Autorizimi për delegim
10. F.4.4. Lista e pritjes
11. F.5.1 Formulari i MMT-Burgjet
12. F.5.2. Annex.
13. F.6. Evidenca ditore e metadonit
14. F.7. Formula mujore e shpenzimeve të metadonit
15. F.8.1. Evidenca javore elektronike e shpenzimit të metadonit
16. F.9. Vërtetim për vazhdim të programit të Metadonit
17. F.10 Dosja mjekësor (001)
18. F.11 Forma e disa indikatorëve shëndetësor (002)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Rregullore

Kriteret për përpilimin e listës për hyrje ne program të metadonit në burgje për të burgosurit

Shkurt 2017, Prishtinë

Ne burgjet e Kosovës dhënia e Metadonit bazohet ne Rregulloren e përgjithshme për mënyrën e dhënies se Metadonit te aprovuar nga Komisioni Profesional i Ministrisë se Shëndetësisë. Te datës 27.03.2012 me numër 05-1609.

I. Te përgjithshme

1. Hyrja ne program te Metadonit është ne baza vullnetare, jo i domosdoshëm dhe jo i obligueshëm qofte për te burgosurin qofte për institucionin.
2. Institucioni nuk është i obliguar qe secilin person qe plotëson kriteret apo bene kërkesë ta fus ne program për shkak te kufizimeve qe ka projekti.
3. Staf i mjekësor është i obliguar që të informoj të burgosurin që ka përdorë droge për ekzistimin e programit te metadonit.
4. Numri i personave qe marrin metadon në burgje është i kufizuar bazuar ne projekt dhe në buxhet.
5. Evidentimi i personave te përshtatshëm për hyrje në program të metadonit bazohet ne dosjen mjekësore, formën mjekësore në pranim ku i burgosuri pyetet për drogat, kërkesën e vete te burgosurit, sugjerimet e pjesëtareve te stafit dhe flete rekomandimi nga sektori publik se personi gjendet ne program te metadonit jashtë.
6. Ne secilin burg formohet ekipi multidisiplinar për hartimin e rang listës për hyrje ne program te metadonit.
7. Komisioni ka përbërje nga:
 - Mjeku përgjegjës i institucionit
 - Mjeket psikiatër te institucionit
 - Psikologu i institucionit
8. Secili i burgosur qe hynë ne program duhet te nënshkruaj kontratën me panelin.

II. Te veçanta – kriteret dhe përparësitë për hyrje ne program

1. Te gjithë personat qe dëshirojnë te hyjnë ne program, shprehin gatishmëri me kërkesë individuale, rekomandime te përshtatshme profesionale dhe qe janë ne gjendje ta kuptojnë programin, ose ekipi multidisiplinar mendon se ka nevojë.
2. Gratë shtatzëna dhe me fëmijë ne gji
3. Personat qe vijnë me flete rekomandime dhe me dëshmi se janë ne program te metadonit ne institucionet publike jashtë burgjeve.
4. Personat qe kane përdorë heroine ne mënyrë IV për një periudhe me shume se 5 vite.
5. Ne raste te tjera prioritet kane ata persona qe e kane përdorë drogën me gjate se te tjerët.
6. Personat qe kane sëmundje te tjera infektive dhe psikiatrike (komorbiditeti).
7. Personat qe kane mase për trajtim te detyrueshëm me Metadon nga Gjykata.

III. Te veçanta – kriteret për dalje nga programi

1. Te gjithë personat qe mendojnë se nuk kane nevojë me për vazhdimin e programit dhe qe dëshirojnë vullnetarisht te dalin nga programi.
2. Te gjithë personat qe përfundojnë dënimin dhe u lëshohet flete rekomandimi për vazhdim ne institucionet e kujdesit publik
3. Te gjithë personat qe paneli konsideron se duhet t'iu ndërpritet programi për shkak se nuk është duke u respektuar nga klienti, nuk ka dobi shëndetësore e as farmaceutike vazhdimi i mëtejme si dhe personat qe keqpërdorin metadonin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Rregullore

Mënyra e dhënies së Metadonit në burgje

Shkurt 2017, Prishtinë